



Save the Children

Emanuela Gjenzali  
Klasa e IX<sup>c</sup>  
Shkolla "Agimi"



See the  
Ability  
Not Disability

**Shqipëria  
Në fokus fëmijët me  
aftësi të kufizuar**

## Hyrje

Ligji për arsimin<sup>1</sup> garanton të drejtën për arsimim të të gjithë personave që jetojnë në Shqipëri, përfshirë të huajt dhe personat pa nënshtetësi, pa dallime në bazë të gjinisë, racës, etnisë, gjuhës, orientimit seksual, besimeve politike apo fetare, situatës ekonomike apo sociale, moshës, vendbanimit dhe aftësisë së kufizuar. Dispozita të tjera ligjore synojnë të vënë në funksionim masat për garantimin e barazisë në aksesin në arsimin parauniversitar<sup>2</sup>. Megjithatë, të dhënat vendore nuk arrijnë të na japin një panoramë të qartë të nivelit në të cilin këto të drejta realizohen në praktikë për



Vizatimet janë krijime të fëmijëve në kuadër të fushatës #VizatoAftësinëEkufizuar

fëmijët me aftësi të kufizuar. Raportet alternative vënë në dukje se grupe specifike fëmijësh të paavantazuar, si fëmijët romë dhe fëmijët e zonave rurale (veçanërisht vajzat), fëmijët e ngjuar për arsye gjakmarrjeje, fëmijët e braktisur nga prindërit të mbetur pa kujdestari, fëmijët e huaj me statusin e azilkërkuesit dhe fëmijët në qendrat e paraburgimit, përballesh me një rrezikshëmri të lartë për t'u përjashtuar nga shërbimet e arsimit bazë i detyrueshëm<sup>3</sup>. Problemi është më akut për fëmijët me aftësi të kufizuar të cilët, për shkak të stigmatizimit, papërshtatshmërisë së mjediseve fizike dhe shkallës së reduktuar të ofrimit të arsimit të veçantë, kanë shumë gjasa të mos regjistrohen kurrë në shkollë apo ta braktisin shpejt atë<sup>4</sup>. Përveç aksesit, edhe mungesa e një arsimit gjithëpërfshirës cilësor është identifikuar si pengesë në garantimin e realizimit të potencialit të plotë të të nxëniet të fëmijëve që janë aktualisht në sistem<sup>5</sup>.

Tabela 1. Të dhëna administrative mbi numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në sistemin arsimor.

Të dhënat	Viti Akademik 2013/2014	Viti Akademik 2014/2015
Numri i fëmijëve me AK të regjistruar në arsimin bazë dhe atë parashkollor	1,920	2,410
Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar të regjistruar në shkollat speciale	702 (240 vajza)	567 (184 vajza)

1) Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

2) Urdhri Nr.2, datë 5.01.2015, i Ministrisë të Arsimit dhe Sporteve "Për miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit datë 2.8.2013 "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor".

3) Shanaj E. et al., Child Notice of Albania (2015) Holandë: UNICEF Holandë, Bruksel, Suedi.

4) Cuninghame C. & Hallkaj E. Child Rights situation Analysis 2012-2015 (2015) Tiranë: Save the Children në Shqipëri

5) Karameta P. et al. Reforma e Arsimit Parauniversitar në Shqipëri (2014) Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

6) Organizata Botërore e Shëndetësisë [http://www.who.int/disabilities/world\\_report/2011/chapter2.pdf](http://www.who.int/disabilities/world_report/2011/chapter2.pdf) (verifikuar më 13.12.2015)

7) Të Dhënat Administrative të Shërbimit Social Shtetëror (ShSsh) për vitin 2014

8) Popullsia 0-18 vjeç është 732,584 (INSTAT, 1 janar 2015)

9) Të Dhënat Administrative të Shërbimit Social Shtetëror (maj 2015)

E udhëhequr nga ky shqetësim, Save the Children Shqipëri nis një **fushatë të re që synon sigurimin e investimeve dhe eliminimin e pengesave me qëllim fuqizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe komuniteteve të tyre në mënyrë që të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuar të mund të ndjekin shkollën dhe të përfitojnë nga një arsim publik cilësor dhe gjithëpërfshirës.**

## Vështrim i përgjithshëm mbi përjashtimin social


Në vend mungojnë të dhëna të sakta të statistikore lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuar pasi Regjistrimi i Fundit i Popullsisë (2011) nuk ofron të dhëna mbi fëmijët 0-15 vjeç. Sipas të dhënave në nivel botëror, përqindja e përhapjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar në vendet me të ardhura të ulëta dhe mesatare llogaritet të arrijë në 12.7% të popullsisë nën 18 vjeç<sup>6</sup>.

Informacioni statistikor në dispozicion në Shqipëri ofrohet nga regjistrat administrativë të fëmijëve me aftësi të kufizuar të cilët përfitojnë mbështetje financiare dhe shërbime të kujdesit social dhe nga numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin arsimor. Regjistrat në fjalë nuk përfshijnë fëmijët që nuk kanë akses në këto shërbime duke ofruar kështu një panoramë jo të plotë.

Megjithatë, mund të paraqitim një informacion të gjerë e të thelluar lidhur me përjashtimin duke kombinuar të dhënat ekzistuese vendore me vlerësimet e bëra në nivel botëror. Në vitin 2014, 17,786 fëmijë me aftësi të kufizuar (0-18 vjeç) kanë marrë mbështetje financiare për aftësinë e kufizuar<sup>7</sup>. Bazuar në llogaritjet e përqindjes së përhapjes në nivel botëror (12.7%), numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar të çdo forme në Shqipëri mund të arrijë në 93,038<sup>8</sup>. Këto llogaritje tregojnë se vetëm rreth 20% e fëmijëve me aftësi të kufizuar mund të identifikohen aktualisht nga sistemi i mbrojtjes sociale. Veç kësaj, vetëm 427 fëmijë<sup>9</sup> (2.5% e totalit të fëmijëve të regjistruar) përfitojnë shërbime të kujdesit social. Kjo situatë lidhet me numrin e kufizuar të qendrave rezidenciale dhe ditore të kujdesit të cilat ofrojnë një gamë të kufizuar shërbimesh dhe janë të vendosura vetëm në pak qytete.

Një vlerësim i pavarur i kohëve të fundit mbi aftësinë e kufizuar të fëmijëve<sup>10</sup> përqipet të ofrojë një vështrim të përgjithshëm mbi përjashtimin brenda sistemit arsimor, siç është paraqitur në grafikun 1. Ai vëren se rreth 35% e fëmijëve me aftësi të kufizuar të moshës 6-15 vjeç dhe rreth 61% e atyre të moshës 15-18 vjeç aktualisht nuk janë në shkollë.

## Përjashtimi i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar në Sistemin Arsimor



Grafiku 1 Fëmijët me aftësi të kufizuar brenda dhe jashtë sistemit arsimor

Gjetjet cilësore na bëjnë të ditur se fëmijët me aftësi të kufizuar në Shqipëri dhe familjet e tyre përjetojnë **stigmatizim dhe diskriminim** të shumfshhtë<sup>11</sup>. Ky është një rezultat i impaktit të ndërthurur të varfërisë, izolimit social (për shkak të refuzimit, paragjykitimit dhe injorancës) dhe mungesës së shërbimeve dhe të mbështetjes. E drejta e tyre ligjore për një trajtim të barabartë dhe politikat që e përforcojnë atë nuk janë plotësuar më tej me përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin profesional dhe publik mbi aftësinë e kufizuar duke filluar nga personat që ofrojnë shërbimet themelore për fëmijët në fushat e shëndetit, arsimit dhe mbrojtjes. Fëmijët dhe prindërit e perceptojnë stigmatizimin si shkakun themelor të sfidave me të cilat u duhet të përballen, i cili u kufizon mundësitë dhe rrit cenueshmërinë e tyre përkundrejt neglizhimit dhe dhunës.

Edhe **pengesat mjedisore** përbëjnë një faktor që vështirëson aksesin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në shërbimet e ofruara. Përgjithësisht, infrastruktura fizike e ndërtesave në Shqipëri nuk është e përshtatur për nevojat e tyre. Sipas një sondazhi mbi ndërtesat e strukturave arsimore të vitit 2013, vetëm 35% e kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare i arrijnë standardet e nevojshme për këta fëmijë<sup>12</sup>. Mungesa e një transporti të përshtatshëm është gjithashtu një shkak tjetër i vështirësive të tyre në akses<sup>13</sup>.

## Analizë e politikave

Kuadri ligjor shqiptar<sup>14</sup> garanton promovimin, mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Megjithatë, adoptimi i të gjitha konventave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me këto të drejta, harmonizimi i tyre me kuadrin ligjor dhe ngritja e mekanizmave detyrues për të garantuar vënien e tyre në zbatim mbeten të paplota.

Për fëmijët me aftësi të kufizuar që janë të përfshirë në sistemin arsimor, **kurrikulat** janë të papërshtatshme dhe/ose nuk janë të hartuara posaçërisht për ta. Nuk ofrohet asnjë burim apo pajisje speciale shtesë për të mbështetur proceset e duhura të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mësuesit janë të pakualifikuar për sa i përket plotësimin të nevojave të fëmijëve dhe të pamotivuar për të bërë ndryshime në stilin e tyre të mësimdhënies. Ata vazhdojnë të përdorin qasjet autoritare të “provuar dhe testuar” duke dështuar në përdorimin e metodave të mësimdhënies gjithëpërfshirëse<sup>14</sup>. Fëmijëve me aftësi të kufizuar jo vetëm u mohohet aksesin i barabartë në arsim, por bëhen kështu edhe më të cenueshëm nga stigmatizimi prej bashkëmoshatarëve të tyre.

Veç kësaj, ky përjashtim merr përmasa akoma më të mëdha për shkak të mungesës totale të mekanizmave të **pjesëmarrjes** së personave me aftësi të kufizuar, veçanërisht fëmijëve<sup>15</sup>. Nuk janë krijuar mundësi të qëndrueshme vetëpërfaqësimi për këta fëmijë, përveçse në raste konsultimi selektiv me një numër të kufizuar individësh gjatë veprimtarive publike.

Në përmbledhje, dëshmitë ekzistuese në Shqipëri konfirmojnë që fëmijëve me aftësi të kufizuar u mohohet e drejta e gjithëpërfshirjes dhe nuk u jepet mundësia të realizojnë potencialin e tyre dhe të jetojnë një jetë përmbushëse.

10) Yoko K. Assessment of the situation of children with disability (2014) Tirana: UNICEF në Shqipëri

11) Yoko K. Assessment of the situation of children with disability (2014) Tirana: UNICEF in Albania

12) Cuko, O. et al., Arsimit gjithëpërfshirës në Shqipëri (2012) Tiranë: Save the Children

13) Partnerë për Fëmijët dhe Avokati i Popullit, Monitorimi i aksesit të Personave me Aftësi të Kufizuara në Shërbimet Publike – Draft-raport i gjetjeve dhe rekomandimeve. 2015, Tiranë.

14) Cuninghame C. & Hallkaj E. Child Rights situation Analysis 2012-2015 (2015) Tirana: Save the Children në Shqipëri

15) Partnerë për Fëmijët dhe Avokati i Popullit, Monitorimi i aksesit të Personave me Aftësi të Kufizuara në Shërbimet Publike – Draft-raport i gjetjeve dhe rekomandimeve. 2015, Tiranë.

16) Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (1992), Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe një sërë ligjesh (Kushtetuta, ligji për diskriminimin, ligji për arsimin parauniversitar, ligji për kujdesin shëndetësor, ligji për aksesueshmërinë).

Ligji i kohëve të fundit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara (2014) përqafton modelin e klasifikimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë<sup>17</sup> dhe përcakton shërbimet që nevojiten për të promovuar jetesën e pavarur të personave me aftësi të kufizuara. Megjithatë, ecuria e miratimit të legjislacionit mbështetës ka qenë e ngadaltë, duke penguar kështu vënien e tij në zbatim. Modeli mjekësor mbetet ende sistemi i klasifikimit të aftësisë së kufizuar. Ai ka mjaft mangësi pasi nuk identifikon një spektër të gjerë aftësish të kufizuara dhe as mjetet për planifikimin ndërsektorial për mbështetjen e integritimit shoqëror të personave me AK.

Në regjistrat financiarë ekzistues të qeverisë nuk është e mundur të shquhen shpenzimet e kryera për fëmijët me aftësi të kufizuara. Veç kësaj, shumica e shpenzimeve aktuale për arsimin janë shpenzime për rrogat e stafit, duke lënë shumë pak në dispozicion për kryerjen e investimeve në burime të tjera për mbështetjen e procesit të të nxënies të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Nuk është e qartë se në ç'mënyrë përgjegjësitë e bashkëndara të qeverisë qendrore dhe atyre vendore lidhur me investimet në infrastrukturën

fizike e kanë përmirësuar në thelb aksesueshmërinë e këtyre fëmijëve. Me reformat e reja të rëndësishme territoriale dhe decentralizuese që janë duke u kryer, kjo situatë ka shumë pak gjasa të përmirësohet në një të ardhme të afërt.

Sikurse edhe në sektorë të tjerë, edhe në atë të arsimit janë bërë reforma të ndryshme në këto pesë vitet e fundit, të plotësuara së fundi edhe me një strategji të re për arsimin parauniversitar. Pavarësisht qëllimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara të përcaktuara në të, strategjisë përgjithësisht i mungojnë qasje të qarta për gjithpërfshirjen. Rishikimi i kurrikulave dhe përmirësimi i trajnimeve paraprake dhe “gjatë punës” për mësuesit janë ndër veprimet parësore për të ardhmen e afërt. Duke pasur parasysh synimet ambicioze që janë paraqitur në strategji dhe burimet e kufizuara financiare, duhet parë se si këto prioritete do të garojnë me të tjerat. Veç kësaj, do të nevojitet një kohë e konsiderueshme përpara se ato të mund të përkthehen në praktika gjithpërfshirëse në shkolla. Ndërkohë, fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla duhet të vazhdojnë të përballen me sfidat e tyre të përditshme.



Vizatimet janë krijime të fëmijëve në kuadër të fushatës **#VizatoAftësinëEkufizuar**



Vizatimet janë krijime të fëmijëve në kuadër të fushatës **#VizatoAftësinëEkufizuar**

## Rekomandime

Në mënyrë që Shqipëria të përmbushë angazhimet e saj përkundrejt fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të mbajë premtimin lidhur me garantimin e trajtimit të barabartë dhe përfshirjes së tyre, nevojitet të ndërmerren një sërë veprimesh:

- Të ngrihet një mjedis ligjor mundësues për fëmijët me aftësi të kufizuar duke përmirësuar përputhjen e legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare dhe duke krijuar lidhje mes reformave dhe programeve të ndryshme në vend;
- Të përmirësohet akses i fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkolla, duke ofruar asistencë dhe transport si edhe shkolla me të sigurta dhe të aksesueshme;
- Të përmirësohet cilësia e të nxënësve gjithëpërfshirës duke ofruar kurrikula të përshtatura, pajisje të përshtatshme dhe burime të tjera dhe duke përmirësuar kapacitetet e stafit për të përshtatur mësimdhënien e tyre me nevojat e fëmijëve;
- Të punohet me normat kulturore/sociale të popullsisë në përgjithësi përmes masash/veprimesh të ndryshme për të garantuar qëndrime pozitive ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuar;
- Të përmirësohen të dhënat mbi fëmijët me aftësi të kufizuar për të informuar vendimmarrjen lidhur me politikën;
- Të përmirësohen mekanizmat e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar në të gjitha nivelet e qeverisjes.

## Save the Children

Rr. "Komuna e Parisit", Lagjia 8,  
Pallatet I Maji, Vila "Lami"; Kutia Postare 8185

Tel: +355 4 2261840

Tel: +355 4 2261929

Tel: +355 4 2266227

Fax: +355 4 2263428

[info.albania@savethechildren.org](mailto:info.albania@savethechildren.org)  
[albania.savethechildren.net](http://albania.savethechildren.net)

 Savethechildrenal

 Savethechildrenalb

